



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

RELACION TEKNIK **(MBI GJENDJEN EKZISTUESE)**

**OBJEKTI: “RIKONSTRUKSIONI I SHKOLLËS SOTIR CAPO DHE
NDËRTIMI I PALESTRESËS”**



TË DHENA TË PËRGJITHSHME

Emërtimi i objektit : Strukturë 2 Kate + 1 Kat Podrum

Destinacioni: Godinë Shërbimi

Vendodhja: Fshat i Ri, Zharrëz

Zona Kadastrale: 3922

Numri pasurisë: 116/1



Ortofoto- Pozicionimi i Godinës së shkolles+Fusha Lojërave

Shkolla “Sotir Capo” është një objekt me 2 kate dhe 1 kat podrum, i rregullt në vertikalitet dhe në plan. Destinacioni kryesor është objekt arsimor për nxënësit e ciklit 9-vjeçar dhe gjimnaz pjesërisht. Godina e shkollës është ndërtuar në dy periudha të ndryshme, një pjesë e ndërtuar në vitet 1976-1980 dhe shtesa e ndërtuar në vitet 2009. Në vitin 2022 është bërë rikonstrukcioni i katit përdhe të shtesës së godinës duke përshtatur ambjentet e saj me qëllim krijimin e kushteve për kopështin “Fshati i Ri”. Objekti është i vendosur në një truall prej 4305 m² dhe sipërfaqja e gjurmës së ndërtimit është përkatësisht kati përdhe 1031.2 m² dhe kati parë 1015.19 m²



Pamje nga Fasada Ballore e shkollës

PËRSHKRIM TEKNIK I OBJEKTIT

Objekti i ndertuar në vitet 76-90 është me themele të vazhduara me gure të vendosura në thellësinë rreth 1m nga kuota e tokës natyrore. Konstruksioni vertikal është mure me tulla silikate me trashësi $t=38\text{cm}$ kati përdhe dhe $t=25\text{cm}$ kati parë. Soleta e objektit fillestar është me tulla “SAP” e mbështetur në breza b/a në drejtimin veri-jug, ndërsa shtesa është me konstruksion beton arme me tulla të lehtësuara dhe solete e kryqëzuar me mbushje me polisterol me traëshësi $t=30\text{cm}$. Gjysma e objektit (pjesa perendimore) duke u nisur nga kafazi i shkalleve është mbi podrum me lartësi $h=2.4\text{m}$. Aksesit nga kati përdhe në katin e parë sigurohet nëpërmjet shkallëve b/a ku rampa e parë në ngjitje ka 9 shkallë $30\times 15\text{cm}$, sheshpushimi $4.80\times 1.90\text{m}$ dhe rampa e dytë me 9 shkallë $30\times 15\text{cm}$.

GJENDJA EKZISTUESE

Shkolla e mesme “Sotir Capo” ka një frekuentim pothuajse nga të gjithë fëmijët e njësisë administrative Zharrëz si një nga shkollat më të rëndësishme të zonës. Nga ana tjetër pjesë e integruar në katin e përdhe të objektit me akses me vete është dhe kopështi për fëmijë “Fshati i Ri” i cili ka një frekuentim prej 20 fëmijësh. Aktualisht godina është në gjendje totalisht të rënduar si nga ana funksionale ashtu dhe infrastrukturore. Në objekt mungojnë salla ku mësimi të zhvillohet brenda parametrave normalë ku të jëtë ndriçimi i duhur, sistemi i ngrohjes, kabinetet për

zhvillimin e lëndëve të ndryshme të cilët kanë të domosdoshme demonstrime faktike. Përgjatë gjithë objektit dallojmë plasaritje të suvatimeve, lagështi, dyer dritare jo funksionale, tualete ne kushte shumë të këqija dhe disa prej tyre aspak funksionale. Sistemi i mbrojtjes nga zjarri, sistemi i alarmit në rast emergjence mungojnë totalisht. Ndriçimi në disa salla është i ulët ose pothuajse fare. Referuar gjendjes aktuale ndërhyrja për rikonstruksionin e objektit është një domosdoshmëri me qëllim së pari ofrimin e kushteve minimale për zhvillimin e një mësimdhënie të rregullt, së dyti rritjen e numri të nxënësve të cilët janë larguar nga kjo shkollë për shkak të kushteve tejet të këqija me të cilat duhet të përballen.

Nga vlerësimi fizik rezulton se :

1. Në faqet e mureve të brendshme dhe të jashtme evidentohet prania e lagështirës dhe hidroizolimi i tarracës është dëmtuar përgjatë viteve.
2. Si pasojë e mungesës së ndërhyrjes dallojmë plasaritje dhe rënie të suvasë si në ambientet e brendshme ashtu dhe të fasadës e cila nuk ka arritur ti rezistojë kushteve atmosferike.
3. Nga kontrolli i përgjithshëm nuk janë evidentuar plasaritje në kollona apo probleme të rëndësishme strukturore.
4. Kabineti i biologjisë dhe i kimisë janë dy nga ambientet ku ndihet më shumë aroma e mykut dhe zhvillimi i mësimin në të tilla kushte bëhet i vështirë.
5. Ullukët e shkarkimit të ujëra të shiut janë të prishura e sjellin lagështi në të gjithë sipërfaqen e murit ku ato ndodhen.
6. Shkolla ka 16 tualete (alla turka), të cilat kanë probleme me nyjet hidrosanitare (tubat e ujit janë të bllokuara), me lagështirën nepër mure dhe dyert janë të dëmtuara. Në të gjitha tualetet ka probleme me rrjetin hidraulik pasi furnizimi me ujë është pothuajse inekzistent.
7. Mungon sistemi i ngrohjes dhe i mbrojtjes nga zjarri.
8. Oborri i shkollës është i pa sistemuar, ujërat e shiut qarkullojnë në sipërfaqe të lirë duke u kthyer në një problematikë për frekuentimin e shkollës përgjatë ditëve me reshje shiu, si dhe problematikë për faktin që grumbullimi i tyre në perimetër të objektit kthehet në një problematikë për transmetimin e lagështisë në xokol dhe themele.
9. Në sipërfaqen e jashtme ka mungesë të ambienteve sportive e rekreative dhe gjelbërim të pasistemuar.



Foto-Gjendja Ekzistuese e Ambjenteve të Brendshme

NDËRHYPJET E PARASHIKUARA NË OBJEKT

Meqënëse ky është një objekt me strukturë me mure mbajtëse dhe si i tillë vështirëson ndërhyrjet në muraturë për të krijuar hapësira të reja me përmasa të ndryshme nga ato ekzistuese në objekt nuk do të ketë nderhyrje strukturore të cilat çënojnë qëndrueshmërinë e objektit.

Në godinë do të ndërhyhet duke riparuar suvatimet e brendshme në të gjithë godinën, përforcim me rrjetë teli dhe suvatim me llac të përzier M25. Për zonat në të cilat si pasojë e mungesës së ndërhyrjeve prej vitesh vërehen plasaritje të muraturës do të përdoret metoda e injektimit të llacit të cimentos të cilësisë së lartë në varësi të gjendjes së degradimit të murit, në hapjet ekzistuese në menyre që të përmitësohen karakteristikat mekanike të murit.

Në të gjithë fasadën do të bëhet riparimi i suvatimeve të demtuara nga lagështira, riparimi i davancialeve të dritareve, vendosje e davancialeve të mermerit. Veshja e fasades do të behet me polisterol me trashesi 5 cm me peshë 15 kg/m³ i montuar në fasade me upa + rrjet + 2 duar kolle + astar + grafiato 1 mm.

Hidroizolimi i taracës do të realizohet për të gjithë sipërfaqën e godinës. Për këtë arsye është e nevojshme ribërja e shtresave të h/izolimit si dhe disa punime riparimi për përmirësimin dhe optizimin e kushteve të ndërtesës dhe të kullimit të ujërave të shiut. Ndërkohë i gjithë parapeti i taracës do të vishet me kornizë llamarinë xingat.

Hartoi:

Ing. Ermenita Mici